

VENDIM
Nr. 126, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË UNIFORMAVE USHTARAKE, GRADAVE, SIMBOLEVE, STEMAVE E FLAMUJVE DEKORATIVË TË STRUKTURAVE DHE SHENJAVE TË TJERA DALLUESE TË UNIFORMËS USHTARAKE, QË MBAJNË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ë”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të uniformave ushtarake, gradave, simboleve, stemave e flamujve dekorativë të strukturave dhe shenjave të tjera dalluese të uniformës ushtarake, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas albumeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Modelet e miratuara me këtë vendim aplikohen, si më poshtë vijon:

a) brenda vitit 2022, uniforma dimërore dhe verore ceremoniale e Orkestrës Frymore dhe e Truprojës së Nderit të Forcave të Armatosura, stemat dhe flamujt dekorativë të strukturave të Forcave të Armatosura;

b) brenda vitit 2025, uniforma e stërvitjes;

c) brenda vitit 2027, uniforma e ceremonialit dhe asaj të punës.

3. Vendimi nr. 694, datë 21.11.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit të uniformave ushtarake, gradave, simboleve, flamujve dhe shenjave të tjera dalluese të uniformës ushtarake, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama